REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr.27, datë 16.03.2022

## PËR
## MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "VLORA MARINA RESORT, HOTEL DHE STRUKTURA AKOMODUESE REZIDENCIALE", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja "ç", 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Marina Residences Vlorë" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

## VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Vlora Marina Resort, Hotel dhe struktura akomoduese rezidenciale", me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Marina Residences Vlorë" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT - KESHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**ADELAJDA ROKA**

Nënshkruar më datë 12/06 2024